



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

Nr. 764 Prot., Datë 10/04/2017



**REALD**  
AKADEMIA E STUDIMEVE TË APLIKUARA

AKADEMIA E STUDIMEVE TË  
APLIKUARA "REALD"

Nr. 221 Prot., Datë 10/04/2017

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI  
NDËRMJET  
UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË  
DHE  
AKADEMISË SË STUDIMEVE TË APLIKUARA "REALD"**

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet midis Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, i përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Arben GJATA, dhe Akademia e Studimeve të Aplikuara "REALD", i përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Sabit BROKAI.

**Baza Ligjore:**

Ligji Nr. 80/2015, "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor ne institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 3, Pika 4, shkronja c) e në vijim.

**Neni 1**

Qëllimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi (më poshtë Marrëveshja) midis Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe Akademia e Studimeve të Aplikuara "REALD", do t'ë përfshijë këto fusha bashkëpunimi:

- Shkëmbimin e personelit akademik të për procesin mësimor;
- Shkëmbimin e stafit akademik, të kërkuesve shkencorë dhe të studentëve në kuadrin e veprimtarisë kërkimore shkencore;
- Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe formuese dhe/ose në Programet Evropiane si Erasmus+, Horizon2020, etj;

- d. Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimitarive të tjera shkencore (konferanca, seminare e botime në fusha me interes të dyanshëm);
- e. Shkëmbimin e literaturës shkencore;
- f. Shkëmbimin e përvojës lidhur me menaxhimin institucional.

#### Neni 2

Bashkëpunimi do të mbështetet mbi bazën e parimeve demokratike dhe në pajtim me autonominë universitare dhe lirinë akademike të tē dyja palëve. Palët zotohen që gjatë bashkëpunimit të tyre, të marrin në shqyrtim nevojat e përbashkëta, me qëllim për tē përfituar nga zhvillimi dhe shkëmbimi mësimor dhe shkencor.

#### Neni 3

Bashkëpunimet e mbështetura në këtë marrëveshje do të përcaktohen me detaje në anekse të veçanta. Këto anekse do të nënshkruhen nga Drejtuesit e Njësive Kryesore të secilës palë të cilët do të pajisen me autorizimin përkatës nga titullari i Institucionit, si dhe pasi Njësítë Kryesore përkatëse brenda universiteteve, të kenë përcaktuar detajet e tyre në praktikë. Anekset do të përcaktojnë subjektet dhe pjesëmarrësit e bashkëpunimit, shpenzimet përkatëse si dhe detaje të tjera të rëndësishme. Anekset pas nënshkrimit do të bëhen pjesë integrale e kësaj Marrëveshje.

#### Neni 4

Kjo marrëveshje i shtrin efektet e saj për një periudhë kohore 4 (katër) vjeçare nga data e nënshkrimit të saj.

#### Neni 5

Kjo Marrëveshje mund tē ndryshohet dhe/ose amendohet me pëlqim tē tē dy palëve. Ndryshimet dhe/ose amendimet do të bëhen në formën e anekseve të Marrëveshjes dhe do të firmosen nga personat e autorizuar të tē dyja palëve.

#### Neni 6

Të dy Universitetet i përbahen politikave të mundësive të barabarta dhe nuk diskriminojnë mbi baza racore, të ngjyrës, moshës, etnive, fetare, paftësive, originës kombëtare apo orientimeve seksuale. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë dhe Akademia e Studimeve të Aplikuara "REALD" do të udhëhiqen nga këto parime në administrimin e kësaj marrëveshjeje.

#### Neni 7

Marrëveshja aktuale është nënshkruar në 4 kopje identike në gjuhën Shqipe. Të gjitha kopjet kanë të njëjtën fuqi ligjore dhe janë njësoj tē vlefshme për tē dyja palët.

Për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë

*Rektori*  
Prof. Dr. Arben GJATJA IM MEKESI



Për Akademinë e Studimeve të Aplikuara

"REALD"  
*Rektori*  
Prof. Dr. Sabit BROKATI

